

bujqësore në Malishevë/Mališevo. Përleshjet e armatosura ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe nisën më 2.08.1998. Pjesëtarët e UJ-së kanë filluar me bombardimin e **Banjës/Banja** herët në mëngjes. Brahimi dhe familjarët e tij u zhvendosën në fshatin fqinj të Kërvasarisë/Kravasarija. Pas dy javë, luftimet pushuan dhe banorët u kthyen në shtëpitë e veta. Familjarët e Brahimit i kanë lënë teshat të ngarkuara mbi traktor, për ta braktisur sërish shtëpinë në mënyrë urgjente në rast të nevojës. Në datën **18.08.1998**, rifilluan bombardimet e fshatit. Predhat filluan të binin në afërsi të shtëpisë së Brahimit. Të gjithë familjarët ishin të përgatitur që ta braktisnin fshatin, por vetëm e prisnin çastin e volitshëm për të hipur në traktor. Kur dolën dhe iu afruan traktorit, një predhë eksplodoi pranë tyre. Një cifël e saj e qëlloi Brahimin në kokë, duke e lënë të vdekur në vend. U plagosën edhe i biri, e reja dhe motra e Brahimit. Po atë ditë, në mbrëmje, familjarët e kanë varrosur Brahimin në varrezat e Banjës/Banja .

**Burimet:** deklarata G.B, FDH-15166; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242.

### **Valentina (Liman) Maloku**

(1979, shqiptare nga Pllaqica/Pločica, komuna e Malishevës/Mališevo, student)

Valentina e studionte historinë në Prishtinë/Priština. Në verë të vitit 1998, forcat serbe i bombardonin shpesh fshatrat në rrethinën e Malishevës/Mališevo. Ishte kjo kohë, kur Valentina gjendej me prindërit, vëllain dhe motrat te shtëpia, në fshatin e saj të lindjes në Pllaqicë/Pločica. Për shkak të bombardimit të fuqishëm, e tërë familja e ka braktisur shtëpinë më 14.08.1998. Qëndronin në një livadh pranë pyllit në afërsi të fshatit. Në datën **19.08.1998**, forcat serbe hapën zjarr në drejtim të livadhit [**Pllaqicë/Pločica**] dhe një plumb ka qëlluar Valentinen në stomak. Prindërit e kanë çuar menjëherë në spitalin e UÇK-së në fshatin Gradicë/Gradica [Glllogoc/Glogovac], ndërkaq më vonë edhe në spitalin e Prishtinës/Priština, ku ajo më 5.09.1998 ndërroi jetë nga plagët. Prindërit

e kanë varrosur më 7.09.1998 në varrezat e fshatit Pllaqicë/Pločica.

**Burimet:** deklarata M.M, FDH-40577; J. Osmani, *Krimet...*, I, 538.

### **Sadri (Ramadan) Gashi**

(29.03.1937, shqiptar nga Vërmica/Vrmnica, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, pesë fëmijë)

### **Adem (Isuf) Morina**

(4.04.1958, shqiptar nga Llashkadrenoci/Vlaški Drenovac, komuna e Malishevës/Mališevo, arsimtar, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### **Hajriz (Haxhi) Morina**

(31.07.1973, shqiptar nga Llashkadrenoci/Vlaški Drenovac, komuna e Malishevës/Mališevo, student, pjesëtar i UÇK-së)

Në datën **24.08.1998**, rreth orës 7:00, Hajrizi, Sadriu dhe Ademi u nisën me një grup banorësh nga Llashkadrenoci/Vlaški Drenovac për të blerë artikujt ushqimor në Malishevë/Mališevo. Ishin të angazhuar nga organizata humanitare *Nëna Terezë/Majka Tereza*. Pas dite, kolona e tyre prej katër traktorësh të ngarkuar me ushqime po kthehej në fshat. Në hyrje të fshatit [**Llashkadrenoc/Vlaški Drenovac**], te vendi i quajtur *Rrafshi/Ravnica*, forcat serbe të pozicionuara në afërsi të Carallukës/Crna Luka hapen zjarr nga topat mbi kolonën e traktorëve. Ademi dhe Sadriu u vranë në vend, përderisa Hajrizin e plagosën rëndë. Ai zbriti nga traktori dhe u strehua në një kanal përskaq rrugës. Dhjetë minuta më vonë, axha i Hajrizit, Veliu, dhe kushëriri Agron Morina e morën Hajrizin dhe e çuan te mjeku në Turjakë/Turjak. Ai nuk ka mundur t'i ofronte ndihmë Hajrizit, por e dërgoi në fshatin fqinj të Panorcit/Ponorac. Nga ky fshat, e dërguan në spitalin ushtarak në Nishor/Nišor [Suharekë/Suva Reka]. Hajrizi ndërroi jetë në rrugë e sipër. Hajrizi dhe Ademi u varrosën në varrezat e *Mëhallës Mzez* në Llashkadrenoc/Vlaški Drenovac, në orët e para të mëngjesit, më 25.08.1998. Po atë ditë, Sadriun e varrosën në varrezat e Vërmicës/Vrmnica. Pas lufte, në muajin maj të vitit 2002, mbetjet mortore të Hajrizit dhe Ademit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të